

E nderuar Zonjë,

Ju ftojme të bëni një mamografi brënda programit të diagnostikimit të hershëm të kancerit të gjirit promovuar nga Regione Emilia Romagna. Mamografia është një analizë e thjeshtë dhe e shpejtë, propozuar femrave nga mosha 45-74 vjeç.

Ju ftojme të paraqiteni në:

Lexoni letrën origjinale

Letra e ftesës dhe fletushka e bashkangjitur janë nisur në Dosjen Shëndetsore Elektronike (nëse e keni aktivizuar), mjekut të familjes dhe me postë të zakonshme në vendbanimin tuaj.

Një teknikë e radiologjisë do ju bëj mamografinë. Analiza është **falas**, si dhe çdo kontroll i mundshëm në të ardhmen dhe nuk nevojitet kërkesa nga mjeku i familjes. Merrni me vete këtë letër. Nëse keni nevojë mund t'ju japim një çertifikatë për të justifikuar mungesën nga puna.

Nëse keni nevojë për më shumë informacione ose dëshironi të ndryshoni takimin telefononi:

nga e hëna në të premte (8.30-17)

të shtunën (8.30-12)

në Centro Screening Mammografico (Qendra e Kontrolleve Mamografike) **(059/438001)** ose mund të shkruani një e-mail në kit adresë: screeningmammo@ausl.mo.it

Do ju dërgojmë përgjigjen e analizës në shtëpi. Nëse do të ketë nevojë për vërtetime të mëtejshme do ju telefonojmë.

Duhet të kujtoni:

- **të paraqiteni me një dokument identifikimi (kartë identiteti, pashaportë)**
- **nëse keni bërë mamografi të tjera jashtë këtij programi, merrini me vete**
- **na telefononi nëse keni bërë mamografi të tjera gjatë vitit të fundit**

Nëse keni vështirsi të rënda të lëvizshmërisë na njoftoni disa ditë para takimit: në mënyrë që t'ju ofrojmë një kujdes më të mirë.

Kujdesuni për shëndetin tuaj, bashkohuni ftesës!